

SHOQERIA TREGTARE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EUROPE EXPLORER"
TIRANE

AKT THEMELIMI

Ne Tirane, sot me daten 05.01.2026 (dymije e njezetegjashte), shtetasi :

Ndrec Llusku, lindur me 23.02.1974 ne Bulshar/Orosh – Mirdite dhe banues në Rruga Andon Zako Cajupi, Tiranë, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Leter Njoftimit H40223123J, me vullnet të lire e të plote dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur:

Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, Ne ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, "Per Tregetaret Dhe Shoqerite Tregtare", krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar "EUROPE EXPLORER" SH.P.K..

NENI 1.

EMERTIMI

Shoqeria tregtare, formohet nga Ortaku i sipercituar, dhe emertohet "EUROPE EXPLORER" SH.P.K., emertimi i se ciles do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2.

SELIA

Selia e shoqerise "EUROPE EXPLORER" SH.P.K. eshte ne Tirane, Rruga " Deshmoret e Kombit" me numer 3/239+1-N36, ZK. 8270, vol. 28, faqe 235.

NENI 3.

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj ne të gjithe juridiksionin territorial të Republikes se Shqiperise.

Me vendim të Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, mund të krijohen ose anulohen (ne rast se jane çelur) seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Republikes se Shqiperise.

Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4.

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100 (njqind) leke, formuar dhe nenshkruar nga Ortaku i shoqerise me 1 kuote me 100 (njqind) leke, i depozituar sipas ligjit.

Ndrec Llusku zoteron, 100% të kapitalit themeltar = 100 (njqind) leke

Ortaku ka pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme.



Shoqeria pergjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 5.

Kapitali nuk mund të jete kurre i perfaqshuar me letra me vlere dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqerise, behet para kerkeses se drejtuar QKR per njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik.

NENI 6.

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte mbi 15 vjet, duke filluar ky afat nga dita e shpalljes se regjistrimit prane QKR Tirane, per njohjen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik.

Me vendim të Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim QKR per të bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare.

NENI 7.

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 8.

Shoqeria çel llogari bankare ne leke vendi dhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shtetore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaket dhe administratori i caktuar prej saj, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte çelur llogaria.

NENI 9.

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar.

Ortaket e shoqerise kane të drejte të transferojne pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire dhe fondet e Kontributet ne natyre.

Transferimet e pjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me akt noterial dhe per nje gje të tille Ortaket duhet të marrin paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo tu behen të ditura.

NENI 10.

Objekti i veprimtarise se shoqerise tregtare "EUROPE EXPLORER" SH.P.K. eshte:

"Operator Turistik dhe Agjensi Udhetimi; Organizimi i udhetimeve/pushimeve individuale dhe/ose ne grup brenda/jashte vendit"

NENI 11.

Ortakët mund të zgjerojnë aktivitetin tregtar të shoqërisë dhe në drejtime të tjera, të cilat janë me interes për mbarevajtjen e shoqërisë.

NENI 12.

Ortakët mund të zgjerojnë shoqërinë duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 13.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që parashikon ligji “Për Tregtarët Dhe Shoqëritë Tregtare”.

Ortakët mund t’ia delegojnë kompetencat e tyre një ose me shumë administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës.

NENI 14.

Administrator i shoqërisë “EUROPE EXPLORER” SH.P.K. është znj. Maria Shehaj, me afat 5 (pese) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 15.

Ky Akt Themelimi u redaktua në 4 ekzemplare, vetëm në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike dhe Ortakët e shoqërisë e aprovojnë dhe e firmosin si më poshtë :

Themeluesi i Shoqërisë Tregtare
“EUROPE EXPLORER” SH.P.K.

Ortaku

Ndrec Llusku

Ndrec Llusku


SHOQERIA TREGTARE
ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR